



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:110524
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05697089

Ac.nr.5808/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen kontestimore të paditëses M.Q., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.Gj., i punësuar tek e paditura, me bazë juridike kompensim i shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.737/21, të datës 19.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.737/21, i datës 19.05.2022, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.737/21, të datës 19.05.2022, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses M.Q. nga Gjakova, dhe ka detyruar të paditurën Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj shumën prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 03.03.2021, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. Në pikën II, ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e gjykuar si në pikën I të aktgjykimit, dhe atë për shumën prej 74.67 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të

gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën, aktgjykimin e atakuar C.nr.737/21 të datës 19.05.2022, ta prish si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditëses duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj si të pabazuar në ligj dhe prova ankesën e të paditurës meqë nuk ekzistojnë shkaqet e paraqitura në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, kundër të paditurës, ka parashtruar padi me datën 03.06.2021, për pagesën e shpërblimeve jubilarë, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditësja t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadijinë e paditësjes, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësjes, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.737/21, të datës 19.05.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadijinë e paditësjes, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në bazë të provave të administruara gjykata ka gjetur se paditësja është e punësuar tek e paditura, me detyrat e punës Infermiere në QKMF në Gjakovë, për më shumë se 30 vite, e që prej kohës kur i ka mbushur 30 vite përvojë pune, të njëjtës nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të tri pagave mujore, të parapara me nenin 17 par. 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e këtyre pagave e ka pohuar edhe e paditura përmes përgjigjes në padi, duke pretenduar se e paditura nuk është nënshkruar i marrëveshjes në të cilën bazohet padija dhe rrjedhimisht nuk bartë përgjegjësi të tilla ndaj palës paditëse. Tutje gjykata ka arsyetuar se lidhur me bazën e kërkesëpadijes ka vendosur duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.3, është paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave mujore të tij”*. Përvojën e punës së paditësjes prej 30 vitesh, gjykata e vërtetoi nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, me numër 201/2, datë 25.05.2021, i lëshuar nga QKMF në Gjakovë, ndërsa lartësinë e pagës bazë mujore prej 377,00 euro, e vërtetoi nga lista e pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, andaj edhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësjes është pjesërisht e bazuar, duke ia njohur shumën prej 1.131,00 euro, me përlllogaritje si në vijim: $(377,00 \times 3 = 1.131,00)$. Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësjes dhe atë në shumë

prej 74,67 euro, pasi që erdhi në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditëses është saktësisht në shumë prej 377,00 euro, bazuar në listën e pagave të administruar në këtë shqyrtim. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika l) e LPK-së.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të të paditurës ka gjetur së aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika l) e LPK-së, sipas secilës dispozitë është përcaktuar së *“Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykimi i formës se prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor”*. Kjo për faktin së në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.337/2020, të datës 12.10.2021, të cilin e paditura ia ka bashkangjitur ankesës rezulton së në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit në fjalë është vendosur për kërkesën e paditëses për kompensimin e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar, e cila kërkesë është njëjtë me kërkesën e paditëses të vendosur me aktgjykimin e atakuar C.nr.737/21, të datës 19.05.2022, ku në këtë rast edhe pala e paditur është e njëjtë. Në bazë të nenit 261 paragrafi 2 të LPK-së është paraparë së *“Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme”*. Ndërsa sipas nenit 262 paragrafi 4 i LPK-së është paraparë së *“Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta”*. Paragrafi 3 i të njëjtit nen përcakton se *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”*. Kurse në bazë të nenit 391 paragrafi 1, pika c) dhe d) e LPK-së është paraparë së *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqvarësia (litispendenca); apo çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Meqenëse nga aktgjykimi C.nr.337/2020, i datës 12.10.2021, të cilin e paditura ia ka bashkangjitur ankesës, nuk mund të kuptohet nëse ky aktgjykim është bërë i formës së prerë pasi që të njëjtit i mungon vula e plotfuqishmërisë, për këtë arsye Gjykata e Apelit nuk ka pasur mundësi që të konstaton faktin nëse ky aktgjykim është bërë i formës së prerë apo kemi të bëjmë me gjyqvarësi në mënyrë që kjo gjykatë në kuptim të nenit 198 paragrafi 1 të LPK-së të vendos që prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të hedhë poshtë padinë. Andaj për arsyet e cekura

si më lartë, aktgjykimi i atakuar u deshtë që të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet që t'i eliminojë shkeljet e konstatuara si më lartë, ashtu që së pari t'i marr në shikim shkresat e lëndës C.nr.337/2020, dhe pas shqyrtimit këtyre shkresave të konstaton faktin nëse kemi të bëjmë me kërkesa të njëjta në mes palëve të njëjta dhe se çështja e paraqitur me padi nga paditësja a paraqet çështje të gjykuar apo kemi të bëjmë me ekzistimin e gjyqvarësisë, ashtu që pas eliminimit të këtyre dilemave të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me nenin 194 dhe 195, paragrafi 1, pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitivi të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5808/2022, datë 30.04.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci